

VENDIM
Nr. 380, datë 20.6.2018

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA TOKË BUJQËSORE NË TOKË TRUALL, PËR NDËRTIMIN E NJË FABRIKE PËR PRODHIMIN, AMBALAZHIMIN DHE SHPËRNDARJEN E UJIT TË PIJSHËM NGA SHOQËRIA “PUKA UJI NATYRAL” SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga tokë bujqësore në tokë truall, të sipërfaqes prej 1 511 (një mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) m², sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e një fabrike për prodhim, ambalazhim dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm nga shoqëria “Puka Uji Natyral” sh.p.k.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Qarkut Shkodër të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit, nga tokë bujqësore në tokë truall, për sipërfaqen prej 1 511 (një mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) m², sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Qarkut Shkodër, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia Fushë-Arrëz për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

TOKË ARË (KATEGORIA V)

Bashkia	Njësia administrative	Fshati	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Pronari	Lloji i pasurisë	Kategoria e tokës bujqësore	Truall i kërkuar (m²)
Fushë- Arrëz	Fushë-Arrëz	Fushë-Arrëz	1657	981/6	Kel Mark Gjinaj Nusha Dod Gjinaj	Arë	V	1511
TOTALI								1511